



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

C.nr.513/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizajt, të cilin e përfaqëson av. [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Komunës së Ferizajt – Drejtoria për Arsim, në çështjen juridike pagesën e pagave përcjellëse dhe jubilare, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.28.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, kundër të paditurës Komunës së Ferizajt – Drejtoria e Arsimit si e bazuar.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit ti paguaj në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,403.10 € (njëmijë e katërqindë e tre euro e dhjetë cent).
- III. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesë padisë përtej asaj që është vendosur si në pikën II të dipozitivit dhe atë në emër të një page e gjysmë jubilare (150%) të pagës bazë në shumën prej 713,38€ (shtatëqind e trembëdhjetë euro e tridhjetë e tetë cent), si e pa bazuar.
- IV. **DETYROHET** e paditura që paditësit shumën si në pikën II të dispozitivit në lartësi prej 1,403.10 € (njëmijë e katërqindë e tre euro e dhjetë cent), me kamat ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë dt.29.05.2018 deri në pagesën përfundimtare si

dhe shpenzime e procedurës në shumë prej 269€, të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka dekluar se nga provat e administruara është vërtetuar fakti se paditësi me rastin e pensionimit me datën 21.05.2018 ka dal në pension tek e paditura dhe në rastin e daljes në pension i ka pasur mbi 40 vite përvojë pune, në rastin konkret e paditura ka pasur obligim që paditësit t'ia paguaj 3 paga përcjellëse në pension në shumë prej 1,403.10€ dhe 150% të pagës bazë jubilare, në shumë prej 713.38€, gjithsej shumën prej 2,116.10€, të cilin detyrim nuk e ka përbushur andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkësepardinë.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën e tij ka dekluar se e kundërshton kërkësë padinë e paditësit pasi që e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive dhe nuk mundet që detyrohet që të paguaj paditësit në emër të pagave përcjellëse në pension dhe një pagë e gjysmë jubilare, përveç kësaj ka theksuar se sipas kontratës kolektive është e paraparë që paga jubilare paguhet me rastin e çdo 7 marsit e që paditësi ka dalur në pension me dt.21.05.2018, që i bije se kjo kërkësë është e parakohshme, andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ti ketë parasysh vërejtjet e të paditurës dhe kërkësë padinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: Kontratën e punës të lidhur në mesë paditësit dhe të paditurës nr.270/15 e dt.05.10.2015, Shiqmin e listës së pagave për tre muajt e fundit, vërtetimin e lëshuar nga SHFMU "Ashmet Hoxha" nr.protokolli 122/18 i dt.16.05.2018 me të cilin vërtetohet përvoja e punës, librezën e punës nr.protokolli 1239/71, autorizimin e paditësit dhënë av.██████████ Parashtresën e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit nr.1263 e dt. 27.06.2018 në të cilën janë specifikuar pagat neto e marr në tre muajt e fundit nga paditësi, vendimin mbi përfundimin e mardhënjes së punë për shkak të arritjes së moshës së pensionit me nr.1181 i dt.29.05.2018, autorizimin e të paditurës dhënë përfaqësuesit ██████████

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension deri sa ishte në marrëdhëniet pune tek e paditura, kurse kontestuese ishte detyrimi i të paditurës ndaj paditësit në lidhje me kërkesë padinë.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension, është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 18.04.2017.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkretë paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për fakti se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar as nga e paditura.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të tri pagave për përcjellje në pension në shumën prej 1,403.10€ ka marr për bazë listën e pagave të nënshkruara nga paditësi ku shihet se paga mujor e tij ka qenë 467.70€.

Në nenin 35 par.8 pika 8.1, 8.2, 8.3 dhe 8.4 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 75%, të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej një pagë bazë, për 40 vjet përvojë punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej 150% të një page bazë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilare, kurse në

100

nenin 35 par.8 pika 8.6 parashihet se shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit, të çdo viti.

Sa i përket pagës jubilare të kërkuar nga ana e paditësit në shumë prej 713.38€, gjykata duke u bazuar në nenin 144.3 të LPK-së, e ka refuzuar kërkesë padinë meqenëse deri në përfundim të shqyrtimit kryesor objekti i kërkesë padisë-paga jubilare nuk është bërë i kërkueshëm pasi që nga provat të cilat gjendjen në shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka dal në pension me dt.21.05.2018, kurse kontrata kolektive ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, kjo kërkesë për paditësin bëhet e kërkueshme në rast se e paditura me dt.07.03.2019, nuk ia përbush këtë detyrim, e tek pas kësaj date paditësi ka të drejtë ta kërkoj pagesën në emër të pagës jubilare me anë të padisë në rast se e paditura nuk ia paguaj me dt.07.03.2019, pasi që paditësi ka dal në pension me dt.21.05.2018, d.m.th. detyrimi i të paditurës në emër të kësaj page rrjedhë tek me dt.07.03.2019, respektivisht kjo shumë nga paditësi mundet me u kërkuar pas datës 07.03.2019, e jo tani andaj dhe kërkesa si e tillë e paditësit është e parakohshme.

Kurse sa i përket pagave përcjellëse gjykata duke u bazarur në nenin 35 par.9 të kontratës kolektive ku thuhet punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut), që dalin në pension përfitojnë pagësë përcjellëse në lartësi prej tri pagave të mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, dhe pika 9.1 ku thuhet se pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit, dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionit, e nga provat material rezulton se e paditura nuk e ka përbushur këtë detyrim të cilën e ka pasur sipas kësaj kontrate

Sa u përketë pretendimeve të të paditurës se e paditura nuk ka mardhënje kontraktuale me paditësin për pagimin e tri pagave për përcjellje në pension dhe asaj jubilare, gjykata ka gjetur se pretendimet e të paditurës lidhur me këtë çështje janë të pabazuara, pasi që nga kontrata kolektive respektivisht neni 2 pika 1.2 është parapë që dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komuna-DK, KD të Universiteeve e intisuracioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj), andaj gjykata lidhur me këtë çështje ka gjetur se një pretendim i tillë është i pabazuar.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së, obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 269€, dhe atë 30€ në emër të taksës për padi dhe, 104€ për përpilim të padis si dhe 135€ për përsaqësim në një seancë nga ana avokatit.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitav të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.513/18 dt.28.09.2018**




KESHILLA JURIDIKE, kundër këtij aktgjykimi është
e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLICA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUOISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAJMA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

Më
Dana

22.10. 2018



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më
Dana

05.11.2018 vit.
Punëtor i autorizuar
Ovlašteni radnik

